



Republika E Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	29.05.19	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	01	Numri	370/01-15836
			Shtojcë	✓

Kaçanik; 29.05.2019

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

. Shpk "EUROTRANS" nga Kaçaniku përfaqësuar nga Jetmir Deda (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Rregullimi i rrugëve në lagjen Cena dhe Shehler

me numër identifikues: **KA652/19/041/521**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Rregullimi i rrugëve në lagjen Cena dhe Shehler

në <sipas dosjes> pjesë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total është **49,642.54 €**,

dhe me fjalë (Katërdhjetëenëntëmijëegjashtëqindëekatërdhjetëedyeuro e 54/100centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Jetmir Deda	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.05.2019	Data:	29.05.2019
Vula:		Vula:	

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE] .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: <ul style="list-style-type: none"> (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda [shëno numrin] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [shëno numrin] ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: Ilir Koraqi
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë prej 30.05.2019 ku e gjith plani artohet në ditarë ndërtimor.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë mbrenda 40 ditëve të punës .
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë (një vitë) nevlere prej 10 % të vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.25 %] për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha

		Punët është 20 %] e Çmimit final të Kontratës.
Kushtet e pagesës	20.1	Kushtet e pagesës janë: Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet ne bazë të raporit te menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: [shëno përqindjen]
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 5,000.00€
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen] .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Cdo mosmarrëveshje do te zgjidhet ne menyre miqësore, ne rast se nuk zgjidhet ne mënyrë miqësorë kompetente është Gjykata komunale Kaçanik.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komunale Kaçanik b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].